



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.522/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Alban Fazliut kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Mitrovicë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) paraqitur përshkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** si e pa lejuar ankesa e Alban Fazliut kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Mitrovicë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) paraqitur përshkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 25.10.2014, të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 23.10.2017 nga Alban Fazliut kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Mitrovicë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i cili pretendon se gjatë procesit të numërimit të rezultateve në zgjedhjet lokale të mbajtura në Mitrovicë ka dyshim të bazuar se ka pasur keqpërdorim të bazuar se ka pasur keqpërdorim të rezultateve nga komisionarët në disa vendvotime. Parashtruesi i ankesës dyshon se ka pasur keqpërdorime në këto vendvotime: 1120B/01D në fshatin Maziq, 1132B/01D në fshatin Melenicë, 1103B/03R në lagjen Shipol, 1105B/01R/02R/03R/04R/05R/06D në lagjen Ura e Gjakut, 1112B/01R/02R/0R/04R/05R/06D në lagjen Ura e Gjakut, 1112B/01R/02R/03R/04D në fshatin Kçiq, 1121B/01R/02D në fshatin Bajgorë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsit në vendvotimet e lartcekura, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen

me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Alban Fazliut, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZLAnr.522/2017 më datën 25.10.2017.



*Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*